**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

**OSHP: 2023/0792**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) si dhe nenit 29 dhe 31 te Rregullores se Punës se OSHP-se 01/2020 e amandamentuar me datën 09. 08. 2023, në përbërjen nga, Isa Hasani-kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE "Valmir Loshi B.I."-Prishtinë, kundër Vendimit për dhënie të një kontrate lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material ndërtimor për rastet emergjente (633-023-073-121)", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) "Komuna e Istogut" 12/01/2024, mori këtë:

## Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e "Valmir Loshi B.I." me nr. 2023/0792 e datës 13/10/2023, kundër""Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material ndërtimor për rastet emergjente (633-023-073-121)", me numër të prokurimit 633-23-9330-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Istogut.

2.Mbetet në fuqi "Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues" datës, 21.09.2023, i Autoritetit Kontraktues, Komuna e Istogut, për të shpërblyer me kontratë OE " Intering Construction " SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material ndërtimor për rastet emergjente (633-023-073-121)".

3.Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues "Valmir Loshi B.I." bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

## Arsyetim

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 01.09.2023, "Komuna e Istogut" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me material ndërtimor për rastet emergjente.(633-023-073-121)", me numër të prokurimit 633-23-9330-1-2-1. Ndërsa me datën 21.09.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE " Intering Construction " SH.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 40,000.00€.

Me 06.10.2023, OE "Valmir Loshi B.I"- Prishtinë ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 09.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 13.10.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Valmir Loshi B.I." me nr. 792/23 për lidhur me aktivitetin "Furnizim me material ndërtimor për rastet emergjente.(633-023-073-121)", me numër të prokurimit 633-23-9330-1-2-1.

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Valmir Loshi B.I." janë parashtruar si në vijim:

*Pretendimi i parë (I):* OE ankues pretendon se AK – Komuna e Istogut me datën 01.09.2023 në platformën elektronike të prokurimit ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është rekomanduar për kontratë OE Intering Construction Sh.P.K., ndërsa neve jemi cilësuar si tenderues i pasuksesshëm. OE ankues pretendon se kur analizohet procesverbali i hapjes dhe njoftimi mbi vendimin e AK-së, shihet që ne jemi ofertues më i lirë se sa OE i rekomanduar për kontratë me çmime për njësi (totalin e njësive) ashtu siç është kërkuar. Ne kemi ofertuar me çmim prej 777.70 €, kurse OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim prej 911.85 €, prandaj OE i rekomanduar për kontratë nuk është dashur dhe nuk mund të shpallet fitues i kësaj kontrate. Eksperti shqyrtues, vlerëson se autoriteti kontraktues, ka bere vlerësimin se ofertave financiare ne kundërshtim me dispozitat e nenit 54 të rregullores Nr. 001/2022, sepse autoriteti kontraktues ne paramasen e publikuar ka dhënë sasitë e përafërta, prandaj fakti qe ka dhënë sasitë e përafërta tregon se këto sasi nuk janë definitive dhe njëherit lidhur me këtë çështje autoriteti kontaktues nuk dhënë asnjë fakt apo argument (se me çfarë sasie te produktit e ka shumëzuar çmimin për njësi, kur dihet fakti se sasia është e përafërt) se si është bazuar te llogaria përfundimtare ku në fund autoritetit kontraktues i ka rezultuar si oferte me çmim me shtrenjtë.

*-Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 24/10/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës, ndërsa me datë 03/11/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0787 me rekomandimet.

Përgjigja e ekspertit shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0792 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, konform nenit 108/A ka parashtruar ankese ne OSHP, me pretendimin se autoriteti kontaktues – Komuna e Istogut, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-se, kryesisht nenin 59 të LPP-se, me këtë rast ka rekomanduar për kontrate një operatore ekonomik i cili nuk i plotëson kriteret e dosjes se tenderit.

Autoriteti Kontaktues – Komuna e Istogut, me datën 03.10.2023 ka publikuar njoftimin B46 - Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm.

Autoriteti kontraktues pas pranimit te ofertave me datën: 21.09.2023, ka formuar komisionin për vlerësimin e ofertave, te cilët pas vlerësimit ne aspektin administrativ, bene vlerësimin e ofertës financiare duke bere llogarit, konkretisht marrin sasitë e përafërta dhe çmimin për njësi te dhënë nga operatoret ekonomik dhe ne fund te procesit, sipas komisionit vlerësues rezulton qe oferta e OE ankues është me shtrenjtë se oferta tjetër pjesëmarrëse.

Ndërsa sipas procesverbalit te hapjes, njeherit edhe sipas paramanës se hartuar dhe publikuar nga vet autoriteti kontraktues, rezulton se oferta e OE ankues Valmir Loshi B.I, është me çmim me te lire për njësi.

*Konstatimi i parë (I):* "Eksperti shqyrtues sqaron se sipas dispozitave te nenit 54 te Rregullores edhe nënshkrimi i kontratës publike ne këto raste behet sipas çmimit për njësi te kërkuar nga autoriteti kontraktues. Prandaj, fakti qe autoriteti kontraktues nuk e din sakte sasinë e produkteve me te cilat dëshiron te furnizohet rrjedhimisht nuk mund ta aplikoje këtë llogari sepse përderisa kërkohet qe çmimi te jepet për njësi dhe autoriteti kontraktues publikon sasitë e përafërta atëherë nuk ka kurrfarë sigurie se me çfarë sasie do te furnizohet për ato produkte te cilat i ka publikuar ne paramase. Andaj, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm."

Lidhur me ketë, me 03.11.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportet e vlerësimit me rekomandimet: Ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, Të anulohet vendimi i AK dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues ka njoftuar Panelin Shqyrtues se nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit ndërsa Operatori Ekonomik Ankues pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës ka gjetur se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar konform dispozitave ligjore të LPP, pasi që AK ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese OE pjesëmarrës, duke u bazuar në dokumentacionin e prezantuar dhe dëshmitë dëshmuese me pas ka rekomanduar OE me ofertën më të lirë të përgjegjshëm. Paneli Shqyrtues vlerëson se vlerësimi i tenderit është kryer sipas kërkesave të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dosjes së tenderit. Andaj, Paneli Shqyrtues vlerëson se AK me të drejt ka shpërblyer OE e rekomanduar pasi që ka përmbushur gjitha

kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit si dhe ka qenë tenderi me i përgjegjshëm me çmim me të ultë.

Paneli shqyrtues vuri në zbatim nenin 1 dhe 6 parimin e ekonomicitetit, si një nga parimet kryesore të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, me ç'rast konstatohet në mënyrë jo kontestuese se oferta e OE të rekomanduar për kontrate konsiston në një çmim me të lirë në raport me ofertën e ankuesit, ngase tek përshkrimi i çmimit AK ka paraparë edhe sasinë e përafërt për secilin artikull dhe ashtu sikurse AK edhe paneli shqyrtues mendon se publikimi i sasisë së përafërt  të artikujëve me të cilët do të furnizohet AK, paraqet një informacion apo pasqyrim shumë të rëndësishëm për të gjitha palët, e posaçërisht edhe për një paraqitje më të dinjitetshme të ofertës. Kështu që, ky përshkrim i çmimeve ka qenë i publikuar për të gjitha palët dhe për çdo paqartësi apo veprim nën supozim si të "paligjshëm", palët kanë pasur mundësi edhe me kërkuar informacione shtesë se si do të bëhet vlerësimi I ofertave apo edhe me atakuar me ankesë në fazën e para-tenderimit.

Andaj, rrjedhimisht paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni  24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i pabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Njëherit Paneli shqyrtues vuri në zbatim nenin 1 dhe 6 parimin e ekonomicitetit, si një nga parimet kryesore të nenit 104 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, me ç'rast konstatohet në mënyrë jo kontestuese se oferta e OE të rekomanduar për kontrate "Intering Construction" ka vlerë më të ulët dhe atë 67,785.00€, konsiston në një çmim me të lirë në raport me ofertën e ankuesit"Valmir Loshi" B.I. me ofertë 68,693.00€ çka do të thotë se është ofertë më joekonomikepër autoritetin kontraktues.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankesës së Operatorit ekonomik ka, vendos ti konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga OE ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Isa Hasani**

**Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E ISTOGUT**
- OE - **Valmir Loshi B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: